

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE PËR
VITIN 2021

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur misionin e INSTAT-it për prodhimin e statistikave asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve për proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit;

Duke marrë në konsideratë se INSTAT-i është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në vend dhe përgjegjës për koordinimin dhe funksionimin e Sistemit Kombëtar Statistikor;

Duke vlerësuar se statistikave zyrtare shpërndahen duke respektuar parimet statistikore të përcaktuara në ligj, duke mbrojtur konfidencialitetin statistikor dhe duke siguruar akses të barabartë për të gjithë përdoruesit;

Duke inkurajuar forcimin e bashkëpunimit të INSTAT-it me prodhuesit dhe përdoruesit e statistikave zyrtare brenda dhe jashtë vendit për të plotësuar nevojat e tyre me informacion cilësor e të përditësuar dhe për të qenë të krahasueshëm me vendet e tjera në rajon dhe Europë,

Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Statistikave gjatë vitit 2021 në drejtim të:

Përgatitjes për kryerjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave, ngritjen e strukturave mbështetëse, punës parapërgatitore sipas strategjisë së zhvillimit të tij dhe publikimit të informacionit për publikun në mënyrë që të rritet shkalla e ndërgjegjësimit të popullatës për dhënien e informacionit dhe besueshmëria në statistikave të prodhuara.

Formalizimit të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe harmonizimit të bazës ligjore në fushën e prodhimit statistikor me ato të BE-së nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit me agjencitë statistikore në proceset e prodhimit statistikor, përafrimit me *acquis* të dy akteve ligjore të propozuara nga INSTAT-i, si dhe zbatimit të rekomandimeve të *Peer Review* 2018 të Eurostat në masën 74%.

Përmirësimit të cilësisë statistikore në përputhje me standardet evropiane duke transmetuar pranë Eurostatit 3.770.059 *data points*, si dhe duke kënaqur kërkesat gjithnjë e në rritje të përdoruesve me një nivel kënaqësisë rankuar në shkallën 3.87 nga 5 pikë të plota.

Zhvillimit të infrastrukturës dhe kapaciteteve profesionale të strukturave të prodhimit statistikor, me qëllim modernizimin e mëtejshëm të proceseve të prodhimit statistikor, specifikisht në procesin e mbledhjes së të dhënave, janë ndërtuar/përditësuar 3 aplikacione CATI/CAWI dhe 9 aplikacione CAPI.

Zhvillimit të një sërë trajnimesh për tema të ndryshme statistikore të organizuar nga INSTAT-i apo nga institucione/organizata të huaja statistikore me pjesëmarrjen e stafit të agjencive statistikore.

Rritjen e rolit të përdoruesve në proceset e aktiviteteve statistikore, si të interesuarit e drejtpërdrejtë në performancën e funksionimit të Sistemit Kombëtar Statistikor nëpërmjet gjithëpërfshirjes në procesin konsultativ të hartimit të projektprogramit të ri të Statistikave Zyrtare 2022 –2026 të të gjitha grupeve të interesit, duke u dhënë zë në këtë proces nevojave të përdoruesve për të dhëna të temave të ndryshme statistikore.

Intensifikimit të bashkëpunimit ndër-institucional nëpërmjet rishikimit të memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet INSTAT-it dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si dhe nënshkrimit të një marrëveshje të re bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë, krahas bashkëpunimit konstant me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Zhvillimit të mëtejshëm të proceseve të shpërndarjes së statistikave nëpërmjet përdorimit të metodave/aplikacioneve moderne në procesin e prodhimit statistikor; gjatë vitit 2021 janë përmirësuar afatet e prodhimit statistikor për 8 aktivitete.

Forcimit të lidhjes me përdoruesit dhe ndërgjegjësimit statistikor duke vijuar takimet me median dhe grupet e ndryshme të interesit me fokus diskutimet për tema të ndryshme statistikore.

Kuvendi rekomandon që Instituti i Statistikave për vitin 2022 të përmirësojë punën në këto drejtime:

Të përmirësojë rolin e institucionit si koordinator i statistikave kombëtare dhe të ndërmarrë masa konkrete me qëllim zgjerimin e Sistemit Kombëtar Statistikor me institucione të tjera publike që prodhojnë statistika zyrtare.

Të intensifikojë punën nëpërmjet reflektimit të përmirësimeve të mundshme të rezultuara nga gjetjet e Pilot Censit, konsolidimit të të gjitha aplikacioneve, manualeve, materialeve të trajnimit dhe materialeve të tjera mbështetëse, që do të bëjnë të mundur realizimin e Censit të Popullsisë dhe të Banesave brenda vitit 2022.

Të sigurojë mbështetje me burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare të fushatës së informimit të publikut për kryerjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave, si aktiviteti më i madh që INSTAT-i parashikohet të realizojë për periudhën në vijim, si dhe vazhdimin e takimeve me pushtetin vendor për një identifikim të saktë të mundësive dhe elementeve që do të mund të sigurohen apo vlerësimin e risqeve për rastet kur njësitë vendore nuk mund ta mbështesin Censin.

Të përmirësojë cilësinë e të dhënave të regjistrave administrative që lidhen me statistikat bujqësore, si dhe të finalizojë procesin e hartimit të projektligjit të ri “Për censin e bujqësisë dhe fermave bujqësore” duke mundësuar përafrimin e standardeve të reja sipas rekomandimeve të Programit Botëror për Censet e Bujqësisë 2020.

Të përafrojë treguesit statistikorë për migracionin e jashtëm dhe azilin me legjislacionin e BE-së, si dhe të nënshkruajë brenda vitit 2022 memorandumun e ri të bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, pjesë e të cilit do të jetë dërgimi i të dhënave për shtetasit shqiptarë me vendbanim jashtë vendit.

Të përmirësojë më tej përputhshmërinë për sa i përket përafrimit me standardet ESA 2010 të burimit të të ardhurave kombëtare bruto (GNI), si dhe të fillojë hartimin e Inventarit të GNI në bazë të përshkrimit ekzistues të burimeve dhe metodave të përdorura për të.

Të intensifikojë marrëdhëniet me shërbimin postar për aktivitetin e mbledhjes së të dhënave në përputhje me rekomandimet *Peer Review* të Eurostatit.

Të forcojë bashkëpunimin me botën akademike dhe medien në prodhimin e statistikave zyrtare duke zhvilluar metodologji dhe trajnime specifike, si dhe të dedikojë një hapësirë të faqes zyrtare të internetit të INSTAT-it për komunikimin me botën akademike, studiuesit dhe medien.

Miraturar në datën 23.5.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla